



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2022

**VENDIM**

**Nr. 147, datë 11.04.2022**

**PËR  
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË  
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË  
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Arbër Çela, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Objekti: “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr.72, viti 2020 në ngarkim të të pandehurit {...}, akuzuar për veprën penale “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal”.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TROPOJË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, çështjen gjyqësore me Kërkues: {...}; Palë e interesuar: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë; Objekti: “Shpalljen të vdekur më datë 03.01.1979 të shtetasit {...}”.

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR POGRADEC**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Seladin Pysqyli, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec; I pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 197/1 dhe 198 të Kodit Penal”.

### **GJYKATA E APELIT DURRËS**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...} Akuza: “Neni 283/2 i Kodit Penal”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Tonin Sterkaj dhe Vojsava Osmanaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 291 dhe 273 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**